



BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 30 Datë 13. 08. 2015

PËR “DHËNIE NDIHME FINANCIARE KOMUNËS TETOVË PËR FAMILJET E DËMTUARA NGA PËRMBYTJET”

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, neni 19 pika 9, neni 32 të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(i ndryshuar); nenit 19 të ligjit nr. 7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); neni 6, paragrafi 3 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28 datë 23.12.2014 për “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015”(i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI

1. Të miratojë transferimin e fondit falas nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në shumën prej 10,000 (dhjetëmijë) Euro, (*ekuivalenti në Lekë sipas kursit ditor zyrtar të këmbimit nga Banka e Shqipërisë*), për komunën e Tetovës me destinacion “Dhënie ndihme financiare për familjet e dëmtuara nga përmbytjet”.
2. Efektet financiare të pikës 1 të vendimit do të përballohen duke pakësuar Fondin Rezervë të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015 dhe duke shtuar në të njëjtën shumë buxhetin e programit të Shërbimeve Sociale të Aparatit të Bashkisë në artikullin 605.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Planifikimit Strategjik , Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI